

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6967
E shtunë, 12 gusht 2023
Çmimi 0.40

AGK-ja e dënon sulmin fizik ndaj ekipit të "Nacionales" në Prizren



Mavraj dënon ashpërsisht dhunën ndaj gazetarëve të "Nacionales"



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJERMANIA ZYRTARISHT NJEH AVOKATËT E LICENCUAR TË KOSOVËS

FAQE 3



Ambasadori i Kosovës në Gjermani, Faruk Ajeti, ka bërë me dije se avokatët nga Republika e Kosovës tani e tutje njihen zyrtarisht nga Gjermania. Ai ka treguar se

avokatët e licencuar nga Kosova do të mund ta ushtrojnë funksionin e tyre edhe në Republikën Federale të Gjermanisë. Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, ka

theksuar se ky hap premtan ta rrisë bashkëpunimin ekonomik dhe ta përmirësojë ekzekutimin e projektit në mes të kufirit gjermano-kosovar

'HEQJA E NDALESËS PËR MALLRAT SERBE NË KËMBIM TË SHFUQIZIMIT TË MASAVE NGA BE-JA'

FAQE 7



IKJA E PUNËTORËVE NGA KOSOVA, SHQETËSUESE!

FAQE 3



"KONTABILISTI" I ALBIN KURTIT DHE NENAD RASHIQIT!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

AKTUALE



ARRESTOHEN PESË PERSONA NË VERI PËR SULM, KONTRABANDË DHE POSEDIM TË NARKOTIKËVE

F. 2

FUNKSIONALIZOHET APARATURA E RE PËR TERAPINË RREZATUESE NË KLINIKËN E ONKOLOGJISË

F. 7

PACOLLI: QYTETARËT PO PAGUAJNË ÇDO DITË PËR VENDIMET E GABUARA TË QEVERISË KURTI

F. 6

EKONOMI



SI MUND TË PËRFITONI SUBVENCION PËR IZOLIMIN E SHTËPISË?

F. 8

SPORT



FUTBOLLI NIS ME DERBIN DRITA - LLAPI

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kolona të gjata në dalje të pikave kufitare Merdar dhe te Dheu i Bardhë

PRISHTINË, 11 GUSHT - Bashkatdhetarët të cilët kanë qëndruar për pushime në Kosovë tashmë kanë filluar të kthehen në shtetet e Evropës ku jetojnë dhe veprojnë. Dy vendkalimet kufitare, Dheu i

Bardhë dhe Merdar, po vazhdojnë të jenë më të ngarkuarat sa i përket kolonave, transmeton "Telegrafi". Të dhënat e fundit të publikuar nga Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar bëjnë me dije

se kolonat në dalje të Merdarit arrijnë deri 1 000 metra, pritja e qytetarëve në këtë pikë po zgjat mbi tri orë. Kurse në dalje të pikës kufitare Dheu i Bardhë kolonat arrijnë deri 600 metra. Pritja e qytetarëve për ta kaluar kufirin

është deri në dy orë. Ndërsa në hyrje të vendkalimeve kufitare gjendja raportohet të jetë e qetë dhe nuk ka kolona. Hyrja në territorin e Kosovës mund të bëhet nga tre deri në pesë minuta.



Arrestohen pesë persona në veri për sulm, kontrabandë dhe posedim të narkotikëve

MITROVICË, 11 GUSHT - Policia e Kosovës i ka arrestuar pesë persona dhe është në kërkim të një personi tjetër pas sulmit që u është bërë zyrtarëve policorë në Zvečan teksa kanë qenë duke e luftuar kontrabandën, ka thënë zëvendësudrejtori i policisë për veriun, Veton Elshani.

Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ai ka thënë se në orët e hershme të së premtes policia ka tentuar ta ndalë një kamion me mallra kontrabanduese, kur kanë nisur të shtënat e grupit, të cilave policia u është përgjigjur njëjtë. "Nuk ka të plagosur. Policia i ka arrestuar pesë persona dhe është në kërkim të një personi tjetër", ka thënë Elshani.

Ky informacion është përhapur

në rrjetin social "Telegram" dhe është interpretuar që Policia e Kosovës "ka qëlluar me armë serbët në Kosovë, dhe i ka kidnapuar pesë prej tyre". "Kamioni në të cilin kanë qenë serbët është shoshitur plotësisht, nuk ka informacione nëse dikush është plagosur", është thënë në njoftimin e bërë nga kanali "Rebelimi është stil jete".

Ky dhe kanale të tjera në gjuhën serbe janë aktive prej rritjes së tensioneve në veri të Kosovës në fund të muajit maj. Atë periudhë serbët lokalë të Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut - komuna me shumicë serbe - i kanë kundërshtuar kryetarët e rinj shqiptarë, ndonëse ata vetë i kanë bojkotuar zgjedhjet e prillit.



Në një kanal tjetër në gjuhën serbe, të quajtur "Patriotizam", në "Telegram" është përmendur se serbët dyshohet se kanë tentuar të dërgojnë furnizime në veri të

Kosovës përmes rrugëve alternative, dhe kanë pyetur nëse transportimi i "produkteve ushqimore bazë është arsye për të shtëna, apo që dikush të

goditet".

Në anën tjetër, Policia e Kosovës i ka thënë Radios Evropa e Lirë se tri makina dhe një kamion janë konfiskuar dhe se, përveç kontrabandës, ka gjetur edhe lëndë narkotike.

Rasti është duke u iniciuar si sulm ndaj zyrtarëve policorë, kontrabandë të mallrave dhe posedim i narkotikëve. Kjo nuk është hera e parë që Policia e Kosovës ka konfiskuar mallra kontrabanduese, lëndë narkotike dhe armë në pjesën veriore.

Të hënën, më 7 gusht, në Mitrovicë të Veriut është gjetur një laborator droge, në të cilin ka pasur pajisje për mihje të kriptovalutave.

Shpërthen varianti i ri i Covidit, OBSH-ja: Rastet me 'Eris' po rriten vazhdimisht



PRISHTINË, 11 GUSHT - Varianti më i ri i Covidit, i cili tashmë njihet me emrin "Eris", që lidhet me nënvariantin Omicron, mund të shkaktojë një valë më të lartë edhe pse deri më tani infektimet nuk janë masive.

Organizata Botërore e Shëndetësisë e konsideron një variant që do të merret në konsideratë, megjithëse rreziku për shëndetin publik është vlerësuar i ulët. "Eris" po përhapet globalisht në Britani të Madhe, Kinë dhe ShBA. Megjithatë, OBSH-ja sugjeroi se varianti nuk përbën kërcënim të veçantë.

"Bazuar në provat, rreziku i shëndetit publik i paraqitur nga varianti i ri vlerësohet i ulët në nivel global", ka njoftuar OBSH, duke shtuar se rreziku duket të jetë në të njëjtin nivel me variantet e tjera qarkulluese. Profesoresha e kërkimit për këtë çështje, Christina Pagel, ka theksuar se nuk ka prova që ky variant mund të shkaktojë pasojë të rënda në shëndet. Ajo vuri në dukje se rënia e imunitetit qoftë nga vaksinimet apo nga infeksionet e mëparshme mund të nënkuptojë se vala e "Eris" mori më shumë kohë për ta arritur

kulmin dhe për këtë arsye mund të jetë më e madhe.

OBSH-ja renditi një sërë veprimesh që u rekomandoi shteteve anëtare t'i jepnin përparësi për ta kuptuar më mirë largimin e antitropave dhe ashpërsinë e variantit më të ri, përfshirë monitorimin e vazhdueshëm.

Javën e kaluar Agjencia e Sigurisë Shëndetësore e Mbretërisë së Bashkuar (UKHSA) publikoi një përditësim, ku thuhej se "Eris" përbën rreth 15 për qind të rasteve të infektiveve me Covid-19 në Angli.

Zjarret pyjore në Havai lënë 55 persona të vdekur

HAVAI, 11 GUSHT - Zjarret pyjore në Maui të Havait i kanë lënë të vdekur të paktën 55 persona, dhe shifrat pritet të rriten, kanë thënë zyrtarët.

Gubernatori Josh Green ka thënë se zjarret e kanë shkrumbuar qytezën Lahaina, duke i lënë mijëra persona pa strehë mbi kokë.

Si pasojë e kësaj katastrofe, që po konsiderohet më e

keqja në historinë e vendit, besohet se janë rrafshuar 1 000 ndërtesa. "Do të duhen shumë vjet për ta rindërtuar Lahainan", ka thënë Green në një konferencë për medie, teksa zyrtarët kanë nisur të planifikojnë si t'i strehojnë personat që u janë djegur shtëpitë.

Lahaina është destinacion i famshëm dhe vizitohet nga dy milionë turistë në vit.

Havai është duke u përballur me zjarre pyjore prej të martës, të nxitura nga erërat e fuqishme dhe thatësia e madhe.

Autoritetet kanë nisur të ndajnë ndihma për të prekurit nga zjarret, ndërsa autoritetet amerikane në Kaliforni dhe Uashington i kanë nisur ekipet e tyre në Havai për t'i rritur përpjekjet e kërkim-shpëtimit.



AGK-ja e dënon sulmin fizik ndaj ekipit të 'Nacionales' në Prizren

PRIZREN, 11 GUSHT - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës - AGK, është i tronditur me sulmin ndaj ekipit të portalit Nacionale, gazetarit Vullnet Krasniqi dhe kameramanit, Arbër Latifi në Prizren. Krasniqi dhe Latifi ishin atje

për të raportuar për protestën e thirrur nga imamët lokalë kundër festivalit "Dokufest". Sipas raportimeve të medias, ata janë sulmuar dhe shtyrë fizikisht nga një pjesë e turmës protestuese derisa po kryenin punën e tyre.

Ky është një sulm i papranueshëm dhe kërcënim serioz për sigurinë e gazetarëve. AGK-ja, kërkon nga Policia arrestimin e menjëhershëm të sulmuesve dhe përballjen e tyre të menjëhershme me drejtësinë.



Mavraj dënon ashpërsisht dhunën ndaj gazetarëve të 'Nacionales'

PRISHTINË, 11 GUSHT - Botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, ka dënuar sulmin ndaj ekipit të "Nacionales" në Prizren të premten. Ai ka shkruar në "Facebook" se ndjen neveri për dhunën ndaj gazetarëve të "Nacionales". "Ndjej neveri për dhunën ndaj gazetarëve të "Nacionales" në protestën minimale të Prizrenit dhe e dënoj ashpërsisht. Tjetër civilizim është Prizreni, jo kështu. Kosova edhe ashtu është lodhur nga të tjerë trushpërlarë. Nuk mban gjatë, sado që po duron. Çdo dhunues të shijojë dhunën e ligjit!", ka shkruar Mavraj.

Postimi i plotë i tij:

Njeriu që i nënshtrohet Zotit me përkulje dhe me fytyrë në tokë supozohet të jetë model i mirësjelljes në shoqëri. Pavarësisht motiveve për të protestuar besimtari shqiptar i cilëso do feje nuk çnjerëzohet as me fjalë, as me sjellje, aq më pak duke përdorur dhunën. Ndryshe do të ishte dicka tjetër, jo besimtar dhe jo i kanuneve tona. Ndjej neveri për dhunën ndaj gazetarëve të "Nacionales" në protestën minimale të Prizrenit dhe e dënoj ashpërsisht. Tjetër civilizim është Prizreni, jo kështu.

Kosova edhe ashtu është lodhur nga të tjerë trushpërlarë. Nuk mban gjatë, sado që po duron.

Çdo dhunues të shijojë dhunën e ligjit!



Gjermania zyrtarisht njeh avokatët e licencuar të Kosovës

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 GUSHT - Ambasadori i Kosovës në Gjermani, Faruk Ajeti, ka bërë me dije se avokatët nga Republika e Kosovës tani e tutje njihen zyrtarisht nga Gjermania. Në një shkrim në "Facebook", ai tha se avokatët e licencuar nga Republika e Kosovës do të mund ta ushtrorjnë funksionin e tyre edhe në Republikën Federale të Gjermanisë. "Tani e tutje avokatët e licencuar nga Republika e Kosovës do të mund ta ushtrorjnë funksionin e tyre edhe në Republikën Federale të Gjermanisë. Kjo është një arritje e jashtëzakonshme jo vetëm për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy shteteve tona, por edhe për drejtësinë e Kosovës. Të njohur nga një vend i rëndësishëm si Gjermania, avokatët nga vendi



ynë mund të përfshihen më lehtë në raste ndërkombëtare dhe ta ofrojnë ekspertizën e tyre në

çështje juridike. Ky kapitull i ri ofron një mundësi të jashtëzakonshme, që dija dhe

përvoja e avokatëve të Kosovës të jenë në proporcion të drejtë me standardet ndërkombëtare të

drejtësisë dhe të integritimit juridik, përkatësisht të përshtatmërisë së kuadrit ligjor të avokatisë së Kosovës me atë gjermane dhe evropiane", ka thënë Ajeti.

Edhe ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, e ka cilësuar lajm të mirë regjistrimin e avokatëve të Kosovës në Gjermani. Rohde ka thënë se ky hap do të ndihmojë që të rritet bashkëpunimi ekonomik në mes të dy vendeve. "Zhvillim emocionues! Avokatët nga Kosova tani mund të regjistrohen pranë shoqatave të avokatëve gjermanë, duke u mundësuar atyre të punojnë drejtpërdrejt në Gjermani. Ky hap premtion ta rrisë bashkëpunimin ekonomik dhe ta përmirësojë ekzekutimin e projektit mes kufirit gjerman-kosovar. Një hap i rëndësishëm përpara!", ka shkruar Rohde në "Twitter".

Vetëm në muajin korrik 1.7 milion vizitorë të huaj e kanë vizituar Shqipërinë

Tiranë, 11 gusht - Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit në Shqipëri, Mirela Kumbaro, ka publikuar të dhënat e

flukseve hyrëse turistike për periudhën janar-korrik 2023, që janë mbi 5,1 milionë vizitorë, duke tejkaluar 31 për

qind më shumë ato të së njëjtës periudhë të vitit 2022, i cili njihet si viti më i mirë ndonjëherë në bilanc

shifrash. "Vetëm për korrikun 1.7 milion vizitorë të huaj kanë zgjedhur të vizitojnë Shqipërinë, ose 26 për qind

më shumë krahasuar me një vit më parë", ka shkruar ministrja Kumbaro në "Facebook".



“Heqja e ndalesës për mallrat serbe në këmbim të shfuqizimit të masave nga BE-ja”

PRISHTINË, 11 GUSHT - Qeveria e Kosovës në periudhën e ardhshme do të duhej ta anulonte vendimin për ndalimin e importit të mallrave të prodhuara në Serbi, por pret që edhe Bashkimi Evropian t'i anulojë masat ndëshkuese ndaj Prishtinës, thotë për Radion Evropa e Lirë (REL), ministri për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiç. Siç shpjegon ai, anulimin e vendimit për ndalimin e importit të mallrave serbe ia kanë kërkuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, përveç tij edhe “disa diplomatë ndërkombëtarë”. Sipas Rashiçit, përgjigja e Kurtit ka qenë se ai si kryeministër dëshiron shtensionimin e plotë, por “që Bashkimi Evropian duhet të tregojë njëfarë mirëkuptimi”. “Është një nga hapat e parë që do ta ndjekim. Se a do të përfshihet së bashku në paketë [heqja e ndalimit të importit të mallrave nga Serbia dhe masat e BE-së ndaj Kosovës] nuk mund t’ju them tani, por është sigurisht gjëja e parë që do të jetë në agjendën tonë”, thotë Rashiç. Megjithatë, ai nuk specifikoi datën e saktë apo në çfarë afati kohor duhet të merren këto

vendime.

Qeveria e Kosovës më 14 qershor ka ndaluar hyrjen e kamionëve me targa serbe dhe importin e mallrave me origjinë nga Serbia për arsye “sigurie”. Ky vendim ishte një përgjigje ndaj arrestimit të tre policëve të Kosovës nga forcat serbe, të cilët që atëherë janë liruar për t’u mbrojtur. Ndërkohë, lejohet hyrja e kamionëve me targa të Serbisë, por jo edhe qarkullimi i mallrave serbe.

Dy muaj më vonë një nga rezultatet e këtij vendimi është se pothuajse nuk ka produkte nga Serbia në zonat e banuara me shumicë serbe në Kosovë, për çka shkroi REL në fund të korrikut. Siç thonë banorët e Mitrovicës së Veriut dhe disa nga biznesmenët, për shkak të mungesës ata i zëvendësuan produktet serbe “kundër vullnetit të tyre” me ato nga vendet e rajonit.

Nga ana tjetër, në fund të qershorit BE-ja vendosi masa ndaj Kosovës, sepse nuk i ndërmoi hapat e duhur për t’i qetësuar tensionet në veri të Kosovës. Disa nga masat e marra ndaj Kosovës janë pezullimi i përkohshëm i punës së të gjitha

grupeve punuese për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit si dhe pezullimi i ftesave për pjesëmarrjen e Kosovës në takimet e nivelit të lartë.

Më pas, më 10 korrik, Kosova arriti një marrëveshje me BE-në për shtensionimin e situatës në veri dhe deri më tani ka ndërmarrë disa hapa në këtë drejtim.

Tensionet në veri të Kosovës u rritën në fund të majit, pasi kryetari i ri i Zveçanit, i Zubin Potokut dhe i Leposaiviqit, nën përcjelljen e Policisë së Kosovës, hynë në ndërtesat komunale. Serbët lokalë e kundërshtuan këtë gjë dhe organizuan protesta, të cilat kulmuan në dhunë më 29 maj në Zveçan, me ç’rast u lënduan dhjetëra protestues dhe ushtarë të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë - KFOR.

Rashiç: Interesat strategjike bëjnë të mundur që të gjithë të fitojnë

Ministri për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiç, vlerëson se

procesi i deeskalimit të situatës në veri të Kosovës po shkon në drejtimin e duhur dhe se në këtë moment “të gjithë duhet të jenë të durueshëm, tolerantë dhe të arsyeshëm”. Ai thekson se anulimi i vendimit për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia do të bëhet me qëllim të shtensionimit të mëtutjeshëm, por rithekson se Kosova “duhet të marrë diçka”. “Ju e dini si është në politikë, ju jepni diçka, ne japim diçka. Këto janë interesa strategjike që i lejojnë të dyja palët të fitojnë dhe nuk kam asnjë problem me këtë, sepse vetë diplomacia do të thotë ta ‘tolerosh’ palën tjetër për të marrë vendime të arsyeshme”, thekson Rashiç.

Bashkimi Evropian nuk iu përgjigj pyetjes së Radios Evropa e Lirë nëse po shqyrtohet heqja e masave ndaj Kosovës. Burime diplomatike të REL-it në BE kanë thënë më herët se heqja e masave ndëshkuese do të varet nga zbatimi i marrëveshjeve dhe obligimeve që ka marrë Prishtina.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, deklaroi më 10 gusht se Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë më

shumë hapa drejt shtensionimit të situatës në veri dhe se blloku evropian është i gatshëm të marrë masa kundër Serbisë nëse nuk bashkëpunon për këtë çështje. Ai nënvizoi se masat e BE-së varen nga mënyra se si Prishtina dhe Beogradi i qasen shtensionimit dhe kthimit në dialog për normalizimin e marrëdhënieve.

Ambasada e ShBA-së: Shmangni veprimet që çojnë në përshkallëzim

Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, zëdhënësi i Ambasadës Amerikane në Kosovë thekson se Kosova dhe Serbia duhet të ndërmarrin hapa për ta promovuar qarkullimin e lirë ndërkufitar të mallrave dhe jo të ndërmarrin veprime që do ta pengonin atë. “U bëjmë thirrje Kosovës dhe Serbisë që t’i depërshkallëzojnë tensionet, t’i shmangin veprimet që mund të interpretohen si përshkallëzuese dhe t’i kthehen menjëherë dialogut [për normalizimin e marrëdhënieve] të udhëhequr nga BE-ja. Presim që Kosova dhe

Pacolli: Qytetarët po paguajnë çdo ditë për vendimet e gabuara të qeverisë Kurti

Prishtinë, 11 gusht - Kryetari i Aleancës Kosova e Re, deputeti, Behgjet Pacolli, ka reaguar pasi ministri për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiç, ka paralajmëruar se së shpejti do të hiqet vendimi për ndalimin e mallrave serbe. Pacolli e ka kritikuar Kurtin, duke thënë se në një portal ndërkombëtar kishte lexuar se:

“Serbia nuk ka nevojë të bëjë asgjë në Kosovë, çka i duhet asaj e bën zotni Kurti”. “Mos të flasim për deklaratat kontradiktore të vartësve të kryeministrit pas çdo takimi me serbët ose në kontekst me ta”, është shprehur Pacolli. Lideri i AKR-së ka thënë se i vjen shumë keq kur sheh se si Kosova dhe qytetarët e saj po

paguajnë çdo ditë për vendimet e “gabuar” të kësaj qeverie. “Me reciprocitetin për targa u legalizuan targa ilegale. Me dërgimin e policisë speciale u dashtë t’i tërhiqim ata, madje u kushëzuam me largimin e kriminelëve dhe barrikadave nga rruga. Me aplikimin e gjobave për targa, serbët tërhiqen nga

institucionet dhe kthimin e tyre e kushtëzojnë me themelimin e Asociacionit. Pa asnjë nevojë, organizojmë zgjedhjet... tani ne vetë i anulujmë ato dhe sipas dëshirës së disubdientëve serbë, organizojmë zgjedhje të reja. Sa zhgënjim, sa mundim, sa shpenzime??”, ka shkruar Pacolli në “Facebook”.



Ikja e punëtorëve nga Kosova, shqetësuese

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 GUSHT - Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat e Kosovës (SPSPK) ka thënë se në shumicën e rasteve punëtorëve të sektorit privat vetëm sa po u rëndohet laku. Sipas SPSPK-së, mungesa e punëtorëve të sektorit privat në Kosovë është më shumë se shqetësuese. Këtë po e bartin në shpinë pronarët e kompanive por, jo rrallëherë, edhe vetë punëtorët e mbetur në punë, pasi që çdo ikje e punëtorëve nga vendet e tyre të punës, mungesën e tyre po duhet ta mbulojnë punëtorët e mbetur. “Atyre po u shtohet edhe me shumë barra e punëve në kompani. Po e përsëritim se ikja e punëtorëve është shqetësuese dhe arsyeja kryesore është mostrajtimi i duhur nga pronarët e kompanive dhe lënia anash nga Qeveria e Kosovës për mbrojtjen e dinjitetit të kësaj kategorie”, është thënë

në reagimin e kësaj sindikate.

SPSPK-ja thotë se sot kemi një pagë minimale 170 euro në fuqi. “Nuk kemi marrëveshje kolektive më shumë se pesë vjet dhe as që flitet për të, nuk kemi sigurime shëndetësore, nuk kemi gjykatë të punës, nuk kemi fond social. Të gjitha këto të premtuara nga qeveritë e kaluara, por edhe nga kjo e sotmja”, është theksuar në reagim.

SPSPK-ja ka reaguar edhe për sigurinë në punë, e cila është trumbetuar shumë që mos të ndodhin kaq shumë vdekje në vendet e tyre të punës por, fatkeqësisht, ka mbetur vetëm në kujtesën e individëve. “Me këto mosveprime po i ndihmoni rinisë që sa më shpejt të ikë aty ku mund ta gjejë veten. Mos të harrojmë se ka edhe kompani që punëtorët e vet i trajton dhe i stimulon komfor ligjeve në fuqi por, fatkeqësisht, jo shumë”, është thënë në reagimin e SPSPK-së.



Serbia t’i zbatonjë plotësisht të gjitha obligimet e tyre nga Marrëveshja e Ohrit”, thuhet në përgjigjen e Ambasadës. Aty shtohet se ky qëndrim i ShBA-së i është përcjellë kryeministrit Kurti nga sekretari i Shtetit, Antony Blinken, më 26 qershor. Që nga fundi i majit, ShBA-ja dhe vendet e tjera perëndimore u kanë bërë thirrje Prishtinës dhe Beogradit t’i kthehen dialogut pas tensioneve të shtuara në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës.

Në mars të këtij viti të dyja palët ranë dakord në Ohër për zbatimin e disa pikave nga marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve bazuar në propozimin e Bashkimit

Evropian. Ajo marrëveshje duhet të zgjidhë një numër të madh çështjesh të hapura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Ndalimi i importit të mallrave nga pikëpamja e biznesmenëve

Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, vlerëson se vendimi i Kosovës për ndalimin e importit të mallrave nga Serbia “e ka përmbushur qëllimin e tij” dhe shton se të dyja palët tani duhet të punojnë për tejkalimin e mosmarrëveshjeve. Ai tregon se përveç Serbisë, dëme pësojnë edhe biznesmenët kosovarë që importojnë lëndë të

parë nga ky vend. “Sipas vlerësimit tonë [Aleanca për Biznesin Kosovar], Serbia ka humbur rreth 60 milionë euro për shkak të ndalimit të eksporteve në Kosovë, po ashtu edhe Kosova ka humbur disa milionë euro në eksport për shkak të mungesës së lëndëve të para [të cilat i importon nga Serbia]”, bën të ditur Shahini për Radion Evropa e Lirë.

Ai thekson se Aleanca e tij për Biznesin e Kosovës po përpiqet t’i “bindë” të dyja qeveritë që ta sigurojnë qarkullimin e lirë të mallrave dhe njerëzve. Sasha Sekuliq nga Shoqata e Biznesmenëve Serbë në Kosovë thekson se kjo nuk është hera e parë që Prishtina zyrtare “sanksionon” mallrat nga Serbia dhe shton se në shekullin XXI “është diçka që s’mund ta marrësh me mend që të mos ketë qarkullim të lirë të mallrave dhe njerëzve”. “Dikush që aspiron të jetë anëtar i BE-së, nga ana tjetër, ndalon qarkullimin e mallrave. Ndalimi i importit të mallrave dhe Bashkimi Evropian nuk shkojnë bashkë”, vlerëson ky biznesmen.

Ai beson se ndalimi i importit të mallrave me origjinë nga Serbia prek kryesisht pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë, por thekson se dëme kanë pësuar edhe biznesmenët shqiptarë. “Artikujt ndërrohen, por janë më të shtrenjtë. Sot çmimi i transportit ndikon shumë në çmimin e produktit dhe nuk mund të jetë i njëjti çmim i mallrave që vijnë, për shembull, nga Pozharevac [qytet në Serbi] dhe Polonia apo Turqia”, thotë Sekuliq për REL-in.

Vendimet politike dhe pasojat ekonomike

Shahini dhe Sekuliqi pajtohen se situata e paqëndrueshme politike ndikon negativisht në ekonomi dhe shtojnë se është koha që biznesmenëve t’u lehtësohet puna. Në këtë kontekst, kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, vlerëson se “politika po shkatërron ekonominë” në vendet e rajonit dhe nënvizon se Kosova dhe Serbia duhet të gjejnë një zgjidhje për

normalizimin e marrëdhënieve sa më parë. “Po e mbajnë popullin nën tension të panevojshëm. Tensionet po e shkatërrojnë rrugën e integritit dhe të investimeve. Tensionet nuk i kanë sjellë askujt të mira, as neve e as Serbisë”, thotë ai.

Sekuliq, po ashtu, thekson se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka vite që po vazhdon, por marrëdhëniet në terren ende nuk janë të relaksuara, prandaj edhe atmosfera për biznes nuk është e mirë. “Në vend se t’u lejojmë biznesmenëve dhe qytetarëve një qarkullim më të lehtë të mallrave, si dhe njerëzve, ne kemi ndalime”, thotë ai.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës në qershor të vitit 2022, Kosova ka importuar mallra nga Serbia në vlerë prej 34 milionë eurosh. Të dhënat e qershorit të këtij viti, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, tregojnë rënie të importit të produkteve serbe, përkatësisht vlera e mallrave të importuara nga Serbia është rreth 13 milionë euro.

Shkëmbimet tregtare Kosovë - Serbi

Serbia është një ndër shtetet me praninë më të madhe të produkteve të saj në tregun e Kosovës. Në pesë vjetet e fundit Serbia ka eksportuar produkte në Kosovë në vlerë mbi 1.3 miliard euro. Gjatë së njëjtës periudhë prodhimet e Kosovës në tregun e Serbisë kanë arritur vlerën e 215 milionë eurove.

QMF në Komoran bëhet me shërbim të rëntgenit

DRENAS, 11 GUSHT - Komuna e Drenasit ka njoftuar se nga mesi i gushtit QMF në Komoran do të ofrojë shërbimin e rëntgenit për të gjithë pacientët. Komuna e Drenasit ka bërë investime të konsiderueshme në shëndetësi dhe ofron përkujdesje parësore 24 orë në QKMF në Drenas dhe QMF në Komoran.

“Përkujdesja parësore në komunën e Drenasit po merr cilësi të reja pas blerjes së aparatit të ri të rëntgenit të vendosur në QKMF. Pajisja e mëhershme e rëntgenit do të funksionalizohet në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Komoran, ku qytetarëve do t’u ofrohet ky shërbim. Kështu, përkujdesja parësore në

Drenas do të ofrojë në dy vende shërbime rentgenologjike, në QKMF dhe QMF. Kompania e cila ka marrë përsipër demontimin, transferimin, montimin dhe lëshimin në punë të rëntgenit, deri nga mesi i gushtit pritet ta bëjë gati në shërbim të qytetarëve”, thuhet në njoftimin e komunës së Drenasit.



Mosmarrëveshje mes dy familjeve, arrestohen katër persona në Mamushë

MAMUSHË, 11 GUSHT - Stacioni Policor në Mamushë më 10 gusht rreth orës 16:00 ka pranuar informacion për një rrahje në mes të disa personave që ka ndodhur në Mamushë. Njësitë policore me urgjencë kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe nga hetimet e para mësohet se pas mosmarrëveshjeve të mëhershme

në mes të dy familjeve ka ardhur deri te përlëshja fizike në mes të pesë personave, ku një nga ta pëson lëndim të rëndë trupor dhe trajtohet në spitalin rajonal të Prizrenit.

Katër persona janë arrestuar dhe janë intervistuar në bazë të procedurave ligjore. Lidhur me rastin është njoftuar

prokurori i shtetit dhe i njëjti ka urdhëruar që ndaj katërve të dyshimtëve të caktohet masa e ndalimit për 48 orë dhe ndaj tyre të ngritet kallëzim penal për veprën penale “Lëndim i rëndë trupor”.

Rrethanat e rastit po hetohen nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me prokurorinë e shtetit.



Kurti shkon në Gjakovë, përkujton dëshmorët Elton Zherka e Përmet Vula



PRISHTINË, 11 GUSHT - Kryeministri Albin Kurti ka bërë homazhe të premtën në varrezat e dëshmorëve në Gjakovë, në nderim të heronjve të lirisë Elton Zherka dhe Përmet Vula, të cilët kanë rënë dëshmorë më 10 gusht 1998 në betejën e Junikut, bashkë me Bekim Berishën - Abejën dhe me Bedri Shalën. “Eltoni dhe Përmeti ishin mobilizuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në të njëjtën ditë, më 18 prill 1998, duke u përbashkuar si luftëtarë

lirie në një kohë kur UÇK-ja ende ishte në ngritje dhe strukturim e sipër. Eltoni dhe Përmeti ishin dy shokë të pandashëm, sportistë me përgatitje të lartë fizike dhe trima me guxim në zemër, që bashkë luftuan në njësitin ‘Komando’. Ata patën fatin e tyre të përbashkët deri në ditën e fundit, që katër muaj pas përfshirjes në luftë, të bien dëshmorë së bashku, ashtu siç së bashku edhe i kishin hyrë rrugës së lirisë”, ka thënë Kurti.

Podujevë, diskutohet për rritjen e inkasimit të mbeturinave

PODUJEVË, 11 GUSHT - Është mbajtur takim në mes të përfaqësuesve të komunës së Podujevës, Kompanisë Regjionale “Pastrimi” Sh.A dhe GIZ-it gjerman. Temë kyçe e takimit ishte rritja e inkasimit të mbeturinave duke shtuar numrin e ekonomive familjare për grumbullimin e mbeturinave nga kompania

“Pastrimi”. Në këtë angazhim kontribut të çmuar është duke dhënë eksperti i jashtëm i angazhuar nga GIZ-i, Michell Rohmann, me përvojën e tij për menaxhimin e mbeturinave.

Në takim u diskutua për metoda praktike, të lehta dhe sa më efikase për futjen në sistem të inkasimit të mbeturinave të

ekonomive familjare të cilat nuk paguajnë për mbeturina. Në fund u vendos të krijohen ekupe nga Kompania Regjionale “Pastrimi” Sh.A, të cilat do të dalin në terren për ta vlerësuar gjendjen reale të ekonomive familjare dhe përfshirjen sa më të madhe të tyre në ofrimin e shërbimeve që ofrohen nga kjo kompani.



Investime gjysmëmilionëshe për sigurimin e ujit të pijshëm në Kamenicë

KAMENICË, 11 GUSHT - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, i ka njoftuar qytetarët se po bëhet sigurimi i ujit të pijshëm në qytet dhe në fshatrat Hodonoc, Muçivërc, Dajkoc dhe Karaçevë e Epërme. Sipas kryetarit Rahimaj, qytetarët e Kamenicës më nuk kanë

nevojë të bëjnë zgjidhje individuale për ujë të pijshëm sepse me projektin në vlerë prej 560 mijë eurosh po bëhen investimet në: hapjen e puseve të reja për qytetin, duke shtuar kapacitetet për 6 litra në sekondë, në vlerë prej 50 000 eurosh. Po investohen 170 000 euro për

kyçjet individuale në ujësjellës për fshatrat Hodonoc, Muçivërc dhe Dajkoc. Në Karaçevën e Epërme së shpejti do të investohen 340 000 euro për rretin e ujësjellësit. Rahimaj, po ashtu, ka falënderuar KRU “Hidromorava” për kontributin dhe bashkëpunimin.



“Kontabilisti” i Albin Kurtit dhe Nenad Rashiqit!



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

Albin Kurti po e përkrah Grupin e Zjarrit: Izet Mexhiti, me një llomtakom të BDI-së, e ka formuar të ashtuquajturin “Grupi i Zjarrit” për t’ia vënë flakën BDI-së dhe për ta djegur politikisht Ali Ahmetin. Po të njëjtin qëllim e kishte para tij Zijadin Sela, një pion i instrumentalizuar i Albin Kurtit që, në përpjekje ta shkatërojë BDI-në dhe Aliun, u dogj vetë pa pasur mundësi të ringritet si Feniksi nga hiri i mbetjeve politike të Selës. Më herët përkrahje të rezervë kishte Blerim Reka që tani është konsull i Kosovës në ShBA, ishte ministër i Maqedonisë së Veriut në Bruksel (NATO) sikur që ishte edhe ministër jetëshkurtër në qeverinë Kurti 1. Albin Kurti e përkrah Blerim Rekën jo si politikan apo se ky është kombëtar i madh, por përkrahja është kryesisht e natyrës private, romantike dhe ... Zijadin Selën e ka përdorur si pykë për ta çarë BDI-në sikur që tani po i përdor dyshen, Izet Mexhiti dhe Bilall Kasamin. Këta të fundit kohë më parë e cilësuan KM si shqiptar i madh, i mençur dhe dhuratë historike. Përralla, thjesht përralla. Asnjëherë nuk e kam kuptuar pse i tjeri ky mosdurim i Albinit ndaj Ali Ahmetit dhe përkrahje e rezervë ndaj të gjithë atyre që janë kundër Aliut.

Ali Ahmeti ka merita të jashtëzakonshme për afirmimin dhe emancipimin politik të shqiptarëve në Maqedoni të Veriut dhe, që për mua paraqet vlerë të pamohueshme që duhet respektuar, gjithmonë dhe gjithkund. Ka deklaruar se BDI-ja është parti e luftës dhe se asnjëherë nuk ka hequr dorë nga lufta e UÇK-së në Kosovë dhe në Maqedoni të Veriut sikur që ka përkrahur rezervë krahun e luftës në Kosovë. Albin Kurti e ka të qartë se nuk ka asnjë mundësi të rrezojë Aliun nga pushteti apo ta zhveshë nga autoriteti që e ka ndërtuar me aktivitet ilegal në Kosovë, Maqedoni, me burgosje, me pjesëmarrje në luftën e Kosovës si dhe në Maqedoni të Veriut prandaj kjo përpjekje është donkishotiane dhe, në vend se ta djeg Aliun, do t’i djeg Bilallin, bashkë me Izetin. Këta do të përdoren nga Albini për një përdorim, pa mundësi riciklimi, ashtu sikur edhe Sela më parë. Në aspektin emocional dhe shpirtëror, reagimi i Albinit për djegien e tyre është i barasvlefshëm me reagimin tim për shkrimin e akullnajave në Kilimanxharo apo në Himalaje. Këtë veprim të mbrapshtë e bëri duke e sfiduar Edi Ramën në zgjedhjet në Shqipëri pas së cilës u nda si u nda, kandidatët për deputetë pësuan cunami elektoral mirëpo mbetën në listën e pagave të Albinit dhe LV-së. Edhe këta e formuan

Katërshen e Anarkistëve të Tiranës në me krye trashëgimtarin e andartëve grekë, Babushka ideologjike e LV-së që dikur ishte luftëtare e Megali Albania e tash po e copëton Kosovën e Vogël në favor të Megali Serbia. E njëjta lojë po luhet edhe në Luginën e Preshevës. Deri më tani i ka emëruar dy këshilltarë, njërin për vete dhe tjetrin për Faustin e bisedimeve me Serbinë, dështakun B.B. Këta “këshilltarë” kryesisht janë për të menaxhuar fondet që Qeveria e Kosovës i ndanë për përkrahësit e LV-së në Luginë sikur që e bëri edhe Hajrulla Çeku në Prishtinë duke ndarë fonde në baza nepotiste dhe partiake. Së paku kështu dyshohet. A është qëllimi i Albinit të zgjidhet Kryegjyshi i të gjithë shqiptarëve apo Baba i Kombit! Po cilit Komb, atij shqiptar që dikur donte ta bashkonte apo këtij kosovar që është ngjizur nga projekte ndërkombëtare dhe serbe duke bërë përpjekje ta sajonnë një komb që kurrë nuk ka ekzistuar, nuk ekziston as tani sikur që as në të ardhmen nuk do të ekzistojë. Krijimi i kombit kosovar është i barasvlefshëm me përpjekjet për krijim të kombit jugosllav. Ideja është nga i njëjti burim sikur që edhe projektuesit dhe përkrahësit kanë pirë ujë po në atë burim, qoftë këta personalisht apo paraardhësit e tyre biologjikë, politikë dhe kombëtar. E pabesueshme sa

çfarë transformimi ta bënë pushteti, sikur që ia bëri Albinit! Po më duket sikur jam duke ëndërruar kur e kujtoj Albinin që e kam përkrahur me të gjitha mjetet e mundshme dhe Albinin e sotëm që është shpërftytuar aq shumë saqë nuk e njeh as veten e tij!

Radoica Radomiroviq, kontabilist i luftës, z/ministër i Kurtit: Albin Kurti po i duhen serbët, me çdo kusht dhe me çdo çmim. Nuk i intereson e kaluara e tyre, mjafton të jetë serb dhe të pranojë të hyjë në kopenë e tij. E nisi me Nenad Rashiqin dhe Radmilla Trajkoviqin, serbë që kanë lodruar në të gjitha sistemet dhe që nuk përkrahen nga askush. Prandaj nuk fituan vota as për ta kaluar pragun e shtëpisë e lëre më atë elektoral. Tash, Nenadi po përpjeket të rekrutojë serbë të tjerë, para se të mbahen zgjedhjet lokale në komunat e veriut e që do të mbahen shpejt, jo se e pëlqen Albini por se e urdhërojnë Borrelli, Lajçaku dhe Eskobari. E paskan emëruar Radoica Radomiroviqin si z/ministër të Rashiqit para thuaja tre muajve ndërsa pikërisht tani e bënë publik. Ky farë Radomiroviqi thuhet se paska qenë pjesë aktive e ushtrisë jugosllave dhe serbe mirëpo nuk paska qenë pjesë e ushtrisë që ka bërë krime kundër shqiptarëve. Paska qenë kontabilist në kohë lufte dhe secili që merr vesh nga çështjet ushtarake e ka të qartë se kontabilistët rreth kokës e kanë kurorën e Shën Pjetrit, nuk i bëjnë askujt asgjë, lëre më të marrin pjesë në krime kundër shqiptarëve. I biri i milicisë në LV tha se Radoica ka qenë kontabilist i uniformuar por se paska bërë vetëm punë të mira kurse Nenad Rashiqi deklaroi se po ky farë Radoica nuk paska lënë gurë pa lëvizur në veri të Kosovës për ta integruar veriun në Kosovë dhe për ta mundësuar shtrirjen e sovranitetit të Serbisë në këtë pjesë të okupuar të Kosovës. Ore i poshtër që ende hunda të qetë qumësht apo qyrra, kujt po i tregon ti se çfarë roli kanë kontabilistët gjatë luftës kur ata janë nën komandë dhe duhet ta zbatojnë çdo urdhër, të vrajë, të djegë, të shpërngulë apo të

dhunojë shqiptarë. Po kush je ti more qyrravec që një ushtar të uniformuar të një ushtrie kriminale që ka bërë krime makabre në Kosovë po përpjeksh ta rehabilitosh duke e portretizuar sikur shpëtimtarin e çifutëve, Oskar Shindler. Oskar Shindler ka bërë lista për të shpëtuar çifutë e ky farë Radomiroviqi ka bërë kontabilitet se sa shqiptarë janë vranë, se sa të tjerë duhet të vriten, sa duhet të shpërngulen dhunshëm, sa shtëpi dhe prona duhet të plaçkiten dhe digjen dhe sa femra shqiptare duhet të dhunohen. Ky ishte kontabiliteti i ushtrisë jugosllave dhe serbe në Kosovë gjatë luftës dhe ky ishte kontabilisti që tani u emërua z/ministër në qeverinë Kurti 2. Në ndërkohë që i biri, gjithashtu ushtar i ushtrisë serbe u emërua drejtor në qeverinë e Oso Kukës në Leposaviq i cili ka filluar t’i paketojë plaçkat për ta lëshuar Kullën e Barotit, gjithashtu në Leposaviq, pa e shpërthyer dhe pa pasur nevojë për sakrificë personale sikur dikur Oso Kuka i vërtetë. Se qeveria Kurti 2 është e mbjellur me ish-udbashë dhe antikombëtarë sikur edhe me pjellën e tyre, nuk kam asnjë mëdyshje por është e pështirë dhe e neveritshme përpjekja për të sajuar arsye të këto emërtime. Ata që dikur kanë kontribuar shumë për çështje kombëtare e që tani në LV janë krejtësisht të hijezuar dhe larg çdo margjine të vendimmarrjes, nuk po bëjnë as gëk e as mëk për këto emërtime. Një për oda e dëgjojnë këngën për Adem Jasharin dhe Zahir Pajazitin, në zyre pinë kafe me Radoica Radomiroviqin. Erdhi edhe kjo kohë, për mua e pabesueshme.

Koka në Norvegji e trupi në Prishtinë, të përzënë dhe të vranë o Armend e pastaj edhe të grinë: Armend Mehaj, ti e di por edhe ne e dimë pse je larguar nga Forca e Sigurisë, jo siç e thotë Qeveria e Kosovës në një komunikatë, por shkak i një rrugaçi. Nuk ke merituar fund tjetër, tash fol, mos hesht! Rugë e mbarë për Norvegji, të uroj gjitha të mirat. Dhe do t’i kesh të mirat, së paku nuk do të keqtrajtohesh nga huliganët dhe injorantët, antikombëtarët dhe zuzarët.

Funksionalizohet aparatura e re për terapinë rrezatuese në Klinikën e Onkologjisë

PRISHTINË, 11 GUSHT - Kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, vizituan Klinikën e Onkologjisë në QKUK për t’i parë nga afër punimet të cilat kanë filluar lidhur me investimet që do ta transformojnë rrënjësisht këtë klinikë. Të premtën ka hyrë në funksion edhe aparatura e re për terapinë

rrezatuese e gjeneratës së fundit, para afatit të planifikuar, me ç’rast deri në fund të vitit do të largohet në tërësi listat e pritjes për radioterapinë si dhe do të përmirësohet cilësia e trajtimit me radioterapi. Kjo është aparatura e dytë për terapinë rrezatuese që është siguruar për të qenë në dispozicion të

shërbimeve onkologjike. Gjatë kësaj vizite Kurti foli për rëndësinë e funksionalizimit të kësaj aparature, të dytën e këtij lloji, dhe për vëmendjen që i ka dhënë qeveria shëndetësisë me buxhetin e këtij viti, me të cilin është rritur për 50 për qind dhe në kuadër të të cilit rreth 60 milionë euro janë ndarë për listën esenciale të barnave.



Si mund të përfitoni subvencion për izolimin e shtëpisë?



PRISHTINË, 11 GUSHT - Me qëllim të kursimit më të madh të energjisë dhe rritjes së mirëqenies në shtëpitë individuale, Qeveria e Kosovës ka vendosur të subvencionojë rreth dy mijë familje për izolimin e shtëpive. Ky subvencion do të përfshijë koston e izolimit të jashtëm të shtëpisë, ndërrimin e dritareve dhe të derës së hyrjes si dhe izolimin e kulmit. Aplikimi në thirrjen për “masa të efijencës së energjisë për shtëpitë individuale të banimit” mund të bëhet përmes platformës elektronike eKosova, në seksionin “Grante dhe subvencione”. Qytetarët mund të aplikojnë nga 8 gushti deri më 25 shtator 2023. Ata të cilët i plotësojnë kriteret, do të përfitojnë një subvencion prej 45-përqindësh të koston të investimit, e kufizuar në shumën prej 5 500 eurosh. Për këtë projekt janë ndarë gjithsej 10 milionë euro. Projekti mbështetet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit IPA - Pako për Mbështetjen e Energjisë, i aranzhuar nga Qeveria e Kosovës dhe i zbatuar nga Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE).

Subvencion më i madh për gratë pronare

Pronat të cilat janë në bashkëpronësi të bashkëshortëve ose në pronësi të grave do të

subvencionohen 50 për qind të koston të investimit. Për të vërtetuar se një shtëpi është në pronësi të një gruaje, ose në bashkëpronësi nga bashkëshortët, në sistem të aplikimit duhet të futet edhe certifikata e pronës, e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj.

Kush ka të drejtë aplikimi dhe cilat janë kriteret?

Të drejtë aplikimi për të përfituar subvencion kanë të gjithë qytetarët të cilët i përmbushin kriteret e përcaktuara nga FKEE-ja. Aplikimet do të trajtohen mbi bazën “kush vjen i pari, shërbehet i pari”, për sa kohë që ka fonde të lira, apo që buxheti të rishikohet nga FKEE-ja. Kusht i detyrueshëm për të përfituar nga subvencioni është izolimi termik i mureve të jashtme të shtëpisë. Kriter tjetër është që shtëpia të jetë e banueshme, si dhe në 24 muajt e fundit të ketë konsum të energjisë elektrike prej së paku 250 kilovatësh orë për muaj. Për të përfituar nga subvencionimi, kusht kyç është që shtëpia të mos ketë izolim termik, ose të jetë nën kërkesat minimale teknike - që përfshijnë: trashësi të izolimit të mureve të jashtme nën 8 centimetra, izolim termik të kulmit nën 10 centimetra, ose dyer dhe dritare joeficiente.

Auditorët e energjisë

Për të vërtetuar se shtëpia nuk është e izoluar, ose është pjesërisht e izoluar, aplikuesit i rekomandohet të angazhojë një auditor të certifikuar të energjisë. Institucionet e Kosovës kanë krijuar një listë me emrat e auditorëve të energjisë të cilët mund t'i kontaktojnë qytetarët. Auditorët e certifikuar të energjisë do të kryejnë inspektim të shtëpisë së aplikuesit për ta analizuar gjendjen ekzistuese. Ata do të ofrojnë rekomandime për instalimin e masave të nevojshme të efijencës së energjisë. Auditori i energjisë do të kompensohet me një shumë shtesë të subvencionit. Kostoja e pranuar për një raport të auditimit të energjisë është kosto fikse, pavarësisht nga madhësia e ndërtesës ose vendndodhja gjeografike e shtëpisë së aplikuesit. Tarifa fikse që do ta paguajë FKEE-ja, në emër të auditimit të energjisë, është deri në 150 euro. Në rast se aplikuesi për çfarëdo arsye nuk ka gjetur një auditor të certifikuar të energjisë për ta bërë auditimin, ai aplikacion do të vendoset në listë të pritjes. Aplikacionet e dorëzuara pas 25 shtatorit nuk do të merren në shqyrtim nga FKEE-ja.

Fondi, po ashtu ruan të drejtën që ta mbyllë afatin e aplikimit edhe para kësaj date në rast se arrihet kuota e buxhetit në dispozicion.

Paraqitja e kërkesës për ndarjen e subvencionit

Pas përfundimit të punimeve, pronari i shtëpisë e njofton FKEE-në se ka përfunduar zbatimin e masave të aprovuara dhe dorëzon formularin përkatës për ndarjen e subvencionit. Përveç formularit për ndarje, përfituesi duhet ta sigurojë edhe faturën ose marrëveshjen e nënshkruar me punëkryesin. Kërkohe, po ashtu, lëshimi i faturës me të gjitha hollësitë e masave të zbatuara të efijencës së energjisë, që korrespondojnë me materialet dhe sasinë e përmendura në paramasë dhe parallogaritje. Aplikuesi duhet, gjithashtu, ta paraqesë dëshminë e transferimit bankar për të treguar se përfituesi ka paguar punëkryesin sipas faturës. Dorëzimi i këtyre dokumenteve është thelbësor për ta siguruar verifikimin e duhur të kërkesës për ndarje të subvencionit. Brenda 30-ditësh nga data e aplikimit për rimbursim të gjitha pagesat për përfituesin do të bëhen përmes transferimit bankar në xhirollogarinë bankare të përfituesit.


Keqpërdorimi i fondeve

Në rast të çfarëdolloj keqpërdorimi të fondeve ose mospërputhjeje me parimet e përcaktuara nga FKEE-ja, përfituesi obligohet që shumën e subvencionuar ta kthejë në llogarinë e FKEE-së brenda dhjetë ditësh nga data e lëshimit të kërkesës për kthim. Sipas legjislacionit në fuqi, aplikuesi do t'u nënshtrohet procedurave të mëtejshme ligjore.

Nevoja për kursimin e energjisë

Statistikat tregojnë se më shumë energji elektrike në Kosovë shpenzon sektori i amvisërisë - rreth 40 për qind të konsumit të përgjithshëm. Kosova nuk arrin ta plotësojë të gjithë kërkesën për furnizim me rrymë nga gjenerimi i brendshëm i energjisë elektrike: Vendi ka kapacitet të prodhojë rreth 800 megavatë rrymë në orë, ndërsa nevojat e saj, në ditë dimri, arrijnë deri në 1 300 megavatë në orë. Kjo diferencë importohet nga jashtë. Vitin e kaluar Kosova u përfshi në një krizë energjetike. Qeveria vendosi masa emergjente për energji, të cilat përfshinin masa të kursimit të energjisë elektrike nga të gjitha institucionet. Nga 1 prilli i sivjetmë në Kosovë kanë hyrë në fuqi tarifatat e reja të energjisë elektrike, me rritje prej 15.4-përqindësh për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Tri transferime bombastike nga KB Peja

PEJË, 11 GUSHT - Kampionia në fuqi e basketbollit të Kosovës, Peja, në 24 orët e fundit ka realizuar tri transferime mjaft të mira. Fillimisht pejanët e konfirmuan transferimin e

Justin Davis. 24-vjeçari është nga Amerika dhe sezonin e fundit ishte pjesë e Lusitania Expert në Superligën portugeze dhe luajti një sezon fantastik me një mesatare 15.8

pikë për ndeshje, 8.5 kërcime dhe 1.9 asistime. Përkundër lojës së tij në sulm, ai njihet edhe për kërcimet e tij dhe topave të fituar në trapez. Më pas klubi nga Rrafshi i

Dukagjinit e ka rikthyer edhe basketbollistin Lis Shoshi. Ky i fundit është edhe pjesë e Përfaqësueses së Kosovës. Transferimi i tretë është Deon Sheqiri.



Futbolli nis me derbin Drita - Llapi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 GUSHT - Kampionati elitari i futbollit në Kosovës për edicionin 2023/2024 fillon sot (shtunë) me dy ndeshje që pritet të jenë interesante. Prishtina, fituese e Kupës, në ndeshjen e parë luan në kampin nacional në Hajvali ndaj skuadrës së inkuadruar në Superligë, Feronikelit 74. Të dyja këto klube kanë bërë mjaft ndryshime në afatin kalimtar të verës, prandaj edhe kjo sfidë pritet të jetë interesante.

Në ndeshjen që zhvillohet sot, Dukagjini i Klinës e pret skuadrën e Malishevës.

Të dielën do të jetë derbi i xhiros së parë. Do të takohen Drita dhe Llapi.

Gjilanasit në kampionatin e fundit përfunduan në pozitën e dytë, derisa ishin jashtë objektivave, por në verë ata investuan shumë në



transferime dhe këtë edicion synojnë titullin e kampionit.

Skuadra e rikthyer në Superligë, Liria e Prizrenit, do ta presë kampionin në fuqi - Ballkanin. Duke pasur parasysh formën e

mirë të suharekasve dhe traditën e madhe të Lirisë, kjo sfidë do të zgjojë interesim të madh te shikuesit.

Ndeshja e pestë në mes të Fushë-Kosovës dhe Gjilanit është shtyrë

me kërkesën e të fundit, pasi po kalon nëpër një krizë të madhe financiare dhe shumica e futbollistëve tashmë janë larguar, përfshi edhe trajnerin Klodian Duro. Fushë-Kosova, në anën tjetër, është rikthyer pas një kohe të gjatë në Superligë dhe sigurisht se mezi pret ta zhvillojë ndeshjen e parë.

Superliga U21, risia e këtij edicioni

Në fillim të javës së ardhshme nis garat Superliga U21, një risi kjo e edicionit të sivjetmë, ku marrin pjesë 10 ekipet elitare me grupmoshën e futbollistëve deri në 21 vjeç. Ky format i ri do të ofrojë mundësi të mëdha për futbollistët e rinj që t'i tregojnë vlerat e tyre dhe të kenë më shumë minuta dhe vazhdimësi të ndeshjeve gjatë një edicioni, duke

u përgatitur kësaj për paraqitje në ekipet e para të klubeve të tyre. Ky format i garave është një tjetër zotim i cili po jetësohet nga programi i mandatit të dytë të presidentit Ademi, njëherësh është tregues i përkushtimit ndaj zhvillimit të talenteve. Kjo ligë besohet se do të krijojë rritje të nivelit të futbollit dhe do të sjellë entuziazëm te futbollistët e rinj, të cilët shpeshherë nuk kanë gjetur hapësirën e duhur në ekipet e para dhe, si rrjedhojë, jo rrallë e kanë braktisur futbollin aktiv.

ORARI I NDESHJEVE

Dukagjini - Malisheva, e hënë 17:00, Klinë
Prishtina - Feronikeli 74, e martë 13:00, stadiumi i 2 Korrikut
Drita - Llapi, e mërkurë 17:00, Livoc
Liria - Ballkani, e mërkurë 15:00, Prizren
Fushë Kosova - Gjilani luhet më vonë

Salihi nga Savehofi kalon tek Amo

PRISHTINË, 11 GUSHT - Hendbollisti nga Kosova, Gzim Salihi, ka ndryshuar skuadër. Nga IK Savehof, ku ishte për kohë të gjatë, 25-vjeçari ka kaluar te skuadra tjetër suedeze, Amo. Amo garon në elitën e Suedisë, ndërsa pritet prej Salihit janë të mëdha. Salihi ishte te Savehofi prej moshës 15 vjeçe, ndërsa me këtë skuadër ka fituar disa tituj të Suedisë. Ai luan në pozitën e bekut, kurse ka luajtur me sukses për të rinjtë e Suedisë. Ka përvujtë në Ligën e Kampionëve dhe në garat e tjera evropiane. Me Savehofin ka luajtur në finale të kampionatit të Suedisë edicionin e kaluar. Amo është skuadër më e vogël, ndërsa Salihi pritet të jetë prej bartësve. "Më duket projekt interesant. Kam luajtur shumë vjet në Savehof dhe kam



ndier se ndryshimi i mjedisit mund të jetë i mirë për mua", ka thënë Salihi.

Federata e Hendbollit e Kosovës

po vazhdon angazhimin me synim që këtë lojtar cilësor ta afrojë te Përfaqësuesja e Kosovës.

Suedia e Kosovare Asllanit në gjysmëfinale të Kupës së Botës së Femrave

AUCKLAND, 11 GUSHT - Dy kombëtare kanë siguruar kalimin në gjysmëfinale të Kupës së Botës për Femra. Spanja ishte kombëtarja e parë që u kualifikua në gjysmëfinale, ndërsa tani ka mësuar edhe kundërshtarin që do ta ketë përballë. Kombëtarja e Suedisë siguroi biletën drejt gjysmëfinale, pasi e eliminoi Japoninë duke e mposhtur me rezultat të ngushtë 2-1. Golat për suedezet i shënuan Amanda Ilestedt (minuta e 32') dhe Filipa Angeldal (minuta e 51'), kurse golin e nderit të Japonia e shënoi Honoka Hayashi në minutën e 87. Po ashtu, për



Suedinë u paraqit edhe futbollistja me prejardhje nga Kosova, Kosovare Asllani, e cila luajti për 73 minuta në fushë, para se të zëvendësohej nga Madelen Janogy. Po ashtu, do të zhvillohen edhe dy ndeshje (Australia-Franca dhe Anglia-Kolumbia) për t'u kompletuar çiftet gjysmëfinaliste të turneut.

Walid Hamidi zëvendëson Rrahmanin te Ballkani

Suharekë, 11 gusht - Kampioni në fuqi i Kosovës, Ballkani, e ka transferuar sulmuesin Walid Hamidi i cili ishte pjesë e Shkupit që nga viti 2021. Ai në sezonin e kaluar ka shënuar 5

gola në 27 paraqitje me klubin nga Maqedonia e Veriut. Algeriani shkon aty pas largimit të Albion Rrahmanit i cili është transferuar te Rapidi i Bukureshtit. "Të dashur

tifoze, kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se kemi arritur marrëveshje me FC Shkupin për transferimin e sulmuesit algerian Walid Hamidi. Futbollistit i dëshirojmë

suksese në fanellën e kampionit të Kosovës drejt arritjes së objektivave tona të përbashkëta. Na priftë e mbara!", thuhet në njoftimin e klubit nga Suhareka.



Daja pas fitores ndaj Lincolnit: Morëm atë që deshëm

SUHAREKË, 11 GUSHT - Skuadra e Ballkanit arriti fitore ndaj ekipit nga Gjibraltari, Lincoln Red Imps (2-0), në ndeshjen e parë të rrethit të tretë kualifikues në Ligën e Konferencës. Trajneri i Ballkanit, Ilir Daja, është

shprehur i kënaqur me fitoren, por ka thënë se skuadra e ka bërë vetëm një gjysmë hapi para. "Morëm atë që deshëm. Kemi ndryshime në lojë dhe në ekip, duke zëvendësuar Rrahmanin dhe Emërllahun, që s'mund t'i zëvendësojmë

për një javë. Disa lojtarë janë me virus dhe gjendja fizike nuk ishte e duhura. Me rezultat 2-0 kemi bërë gjysmë hapi para, e rëndësishme është ta mbyllim me kualifikim pavarësisht prej ndeshjes së sotme", ka thënë Daja.



Dushku përfaqëson Kosovën në Kongresin e FIBA-s në Manila

Prishtinë, 11 gusht - Sekretarja e përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Elvira Dushku, do të marrë pjesë në cilësinë e delegates nga Kosova në Kongresin e Federatës Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA) që do të mbahet më 23 e 24 gusht në Manila (Filipine). Në kuadër të Kongresit do të mbahen edhe zgjedhjet në FIBA për

mandatin 2023-2027, kurse në program është edhe ceremonia e shpalljes së "Hall of Fame" për vitin 2023, si dhe punëtori të ndryshme që do të shërbejnë për shkëmbim të përvojave për delegatët/et e Federatave Nacionale. Dushku do të marrë pjesë edhe në hapjen solemne të FIBA Kampionatit Botëror që do të organizohet në Filipine dhe

Japoni prej 25 gushtit deri më 10 shtator. Dushku do të jetë në dy ndeshjet hapëse të Botërorit: Angola - Italia dhe Republika Dominikane - Filipine. Duhet theksuar se kjo është hera e dytë për Dushkun që e përfaqëson FBK-në në Kongres të FIBA-s, pasi më parë këtë e ka bërë në Kongresin e vitit 2019 të mbajtur në Pekin (Kinë).



Kryeministri Kurti vlerëson rezultatet e sportistëve në arenën ndërkombëtare

PRISHTINË, 11 GUSHT - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar Komitetin Olimpik të Kosovës, me ç'rast është pritur nga drejtuesit e KOK-ut, në krye me presidentin Ismet Krasniqi. Të pranishëm në takim ishin edhe zëvendësministria e MKRS-së, Daulina Osmani, sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Besim Aliti dhe nënpresidentët Gazmend Maxhuni e Milaim Kelmendi.

Presidenti Krasniqi falënderoi kryeministrin Kurti për angazhimin në mbështetje të sportit dhe sportistëve, si dhe përkushtimin për përmirësimin e kushteve infrastrukturore. Kryeministri Kurti i përgëzoi drejtuesit e KOK-ut për zyrat e reja, derisa vlerësoi punën dhe të arriturat e KOK-ut, me theks të veçantë rezultatet e sportistëve



tanë në arenën ndërkombëtare. Palët u pajtuan për thellimin e bashkëpunimit për arritjen e qëllimit për marrjen e organizimit të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, për çka presidenti Krasniqi

falënderoi kryeministrin për mbështetjen e fuqishme. U pajtua edhe për bashkëpunim në rrugën drejt prezantimit sa më të mirë edhe në Lojërat Olimpikë "Paris 2024".

SHKURT

Lëndohet Courtois, Reali kërkon portier të ri

Pas lëndimit të Thibaut Courtois gjatë seancës stërvitore, Real Madridi ka filluar "operacionin" për të jetuar një portier që do të jetë zëvendësues për belgun. Mediet spanjolle raportojnë se Reali ka në listë katër emra: Kepa i Chelseat, Bounou i Sevillës, ish-portieri i "galaktik" Keylor Navas dhe David de Gea. Courtoisi ka këputur ligamentet dhe pritet të jetë jashtë fushës për një kohë të gjatë.

Kloppi konfirmon transferimin e Coicedos

Ylli Brightonit, Moise Coicedo, i cili ishte objektiv i shumë skuadrave të mëdha gjatë kësaj merkato, ka arritur marrëveshje me Liverpoolin. Lajmin për arritjen e një marrëveshje e ka bërë vetë tekniku i Liverpoolit, Jurgen Klopp. "Mund të konfirmoj se marrëveshja me Brightonin për Muise Caicedo është arritur", ka thënë tekniku gjerman. Gazetari Fabrizio Romano ka konfirmuar se ky transferim i ka kushtuar Liverpoolit 130 milionë euro.

PSG-ja lejon Neymarin t'i bashkohet Barçës këtë verë

Ditët e fundit është folur për rikthimin e Neymarit në Barcelonë, gjashtë vjet pasi ai u largua nga klubi për t'u bashkuar me Paris Saint-Germainin në një marrëveshje rekord që kushtoi 222 milionë euro. PSG-ja dëshiron ta heqë qafe Neymarin para fundit të afatit kalimtar të kësaj vere dhe ka të ngjarë të pranojë oferta shumë më të ulëta se vlera që pagoi në vitin 2017. Kjo është e mirë për Barcelonën, e cila nuk mund të përballojë të shpenzojë shumë për shkak të çështjeve financiare.

Llorisi, afër transferimit te Lazio

Hugo Lloris dëshiron të luajë në Ligën e Kampionëve, mundësi që Tottenhami nuk ia dhuron. Portieri francez ka edhe një vit kontratë me "Spursin", por shpejt pritet të vijë mbyllja e bashkëpunimit me marrëveshje. 36-vjeçari mbron portën e skuadrës londineze prej gushtit të vitit 2012, ndërkohë që më parë ka luajtur me Nicen dhe Lyonin në vendlindje. E ardhmja lidhet me Italinë. Shtypi francez shkruan se Lloris mund të kalojë te Lazio. "Bardhekaltrit" këtë sezon do të luajnë në grupet e Ligës së Kampionëve, kompeticion ku përvoja ka një rëndësi të veçantë. Llorisi numëron 145 ndeshje me kombëtaren e Francës. Me "Gjelat" fitoi Botërorin "Rusi 2018" si protagonist, teksa ka luajtur edhe dy finale të tjera, atë të "Euro 2016" dhe Kupën e Botës "Katar 2022", të dyja të humbura kundër Portugalisë së Cristiano Ronaldos dhe Argjentinës së Leo Messit.

Mane: Ronaldo e bëri më të lehtë kalimin tim në Arabinë Saudite

Sadio Mane u largua nga Bayern Muncheni pas vetëm një sezoni, për t'u transferuar në Arabinë Saudite tek Al-Nassr. Ai ka dhënë

një intervistë për mediet, ku ka treguar arsyet për zgjedhjet e tij. "Bayemi? Mendoj se të gjithë e panë se sa shpejt ndodhi

gjithçka. Nuk ishte një vendim i lehtë. Këtu (Al Nassr) është Cristiano Ronaldo, i cili është një nga lojtarët më të mirë në histori,

ose edhe më i miri. Sigurisht, kjo e bëri vendimin më të lehtë. Ne pamë në Kupën e Botës së Katarit 2022 që lojtarët sauditë janë

teknikisht të mirë. Ata dinë të luajnë me top dhe dua që ky ekip të ketë një sukses të vërtetë", ka thënë Mane.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 630/1
Dt: 11.08.2023

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 07/2017, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencionit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPLLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendeve të punës në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj dhe Qendrën e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2023/2024

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) mësimdhënës/e për TIK (20 orë)	Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës/e për Gjuhë angleze (20 orë)	Zëvendësim deri në kthim e mësimdhënës nga pushimi i lehonisë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MASHTI), niveli i 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Procedurat e konkurrimit:**
 - Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacioni dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj dhe në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj.
 - Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
 - Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Një(1) Inkasant/e - KRM "Uniteti" Sh.A Mitrovicë - i Konkursit të shpallur me datë 25.07.2023

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej datës **12.08.2023**. deri me datë **18.08.2023** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Receptionist/e - KRM "Uniteti" Sh.A Mitrovicë - i Konkursit të shpallur me datë 25.07.2023

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej datës **12.08.2023**. deri me datë **18.08.2023** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Genti-El” SH.P.K. me seli në Fushë Kosovë, pronar Abedin Ibrahimimi ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810199647 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Genti-El” D.O.O. Fushë Kosovë, sa vllasnikom Abedin Ibrahimimi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810199647 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Genti-El” L.L.C. with headquarters Fushë Kosovë, with owner Abedin Ibrahimimi, has come to the decision to quit its business: 810199647 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Nika Compani” SH.P.K. me seli në Vushtrri, pronar Adnan Nika, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811940099 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Nika Compani” D.O.O. Vushtrri, sa vllasnikom Adnan Nika, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811940099 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Nika Compani” L.L.C. with headquarters Vushtrri, with owner Adnan Nika, has come to the decision to quit its business: 811940099 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Urbanistika Real Estate” L.L.C. me seli në Prishtinë, pronar Urim Nuredini, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811984138 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Urbanistika Real Estate” L.L.C. Pristina, sa vllasnikom Urim Nuredini, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811984138 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Urbanistika Real Estate” L.L.C. with headquarters Prishtina, with owner Urim Nuredini, has come to the decision to quit its business: 811984138 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Sanije Poroshtica shpall të humbur vulën personale të Ordinancës Dheu i Bardh nr. 4- Qendra e Mjekësisë Familjare.

- Mery's V& F- SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810816621.

- Xheneta Ujkani shpall të pavlefshme diplomën e masterit drejtimi Ekonomiks në UP.

- Afrim Vehapi B.I. DPZ “ONIKS-1” shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, për import-export, me numër unik të biznesit: 810345654.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ROYAL CROWN;
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L